

# Raport mbi progresin e avokimit publik të Nismës KOMRA

Tetor 2011 – gusht 2012.

Faza e dytë e procesit të KOMRA-s, *Institucionalizimi i Nismës për KOMRA-n*, e ka filluar formimin e Ekipit Rajonal të Avokuesve Publik të (ERAP) në tetor të vitit 2011. Anëtarët e ekipit, me thirrjen e Fondit për të Drejtën Humanitare, përmes projektit “Përkrahja e procesit KOMRA” i kanë propozuar organizatat partnere në realizimin e projektit, të cilat kanë marrë pjesë aktive në procesin konsultativ trevjeçar e gjysmë mbi mandatin e KOMRA-s: ERAP-in e përbëjnë: Zdravko Grebo, profesor në Fakultetin Juridik në Sarajevë, Dino Mustafiq, regjisor i teatrit, dhe gazetaren Xhenana Karup-Drushko (BeH), Zharko Puhovski, profesor në Fakultetin Filozofik në Zagreb (Kroaci), Biljana Vankovska, profesoreshë në Fakultetin Filozofik të Shkupit (Maqedoni), gazetari Igor Mekina (Slloveni), gazetari Dushko Vuković (Mali i Zi), gazetari Adriatik Kelmendi (Kosovë), gazetari Dinko Gruhonjiq dhe aktivistja për të drejtat e njeriut, Natasha Kandiq (Serbi). ERAP e ka mbajtur **takimin përgatitor në datën 9.10.2011**, në Beograd. Në këtë takim është analizuar situata politike në secilin vend veç e veç, kurse pastaj është diskutuar mbi nevojën e harmonizimit të avokimit politik me aktivitetet për fuqizimin e vëmendjes publike dhe përkrahjen për Nismën për themelimin e KOMRA-s.

ERAP e ka mbajtur **Takimin e parë** në datën **3.11.2011** në Zagreb. Diskutimi i është kushtuar fillimit të procesit të avokimit politik. Duke pasur parasysh se përfaqësuesit e institucioneve shtetërore të Malit të Zi të parët e kanë ofruar përkrahjen e fuqishme për themelimin e KOMRA-s, ERAP ka vendosur të kërkojë takim me kryetarin e Malit të Zi, Filip Vujanoviçin dhe ta lus atë që ai ta fillojë procedurën e institucionalizimit të Nismës për KOMRA-n.

## **Përkrahja e kryetarit të Malit të Zi**

ERAP, të cilin e kanë përfaqësuar Natasha Kandiq, Zdravko Grebo, Dinko Gruhonjiq dhe Dragoljub Dushko Vuković, ka biseduar, në datën 12.12.2011, në Podgoricë, me kryetarin e Malit të Zi, Filip Vujanoviçin mbi mundësitë e themelimit të KOMRA-s. Në biseda ka marrë pjesë edhe Daliborka Uljareviq, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për Arsimitim Qytetar në Mal të Zi.

Kryetari Vujanoviç ka shprehur gatishmërinë që me anë të një letre personale t'i thërrasë kryetarët e shteteve të rajonit që përkrahjen e tyre të përgjithshme për nismën për themelimin e KOMRA-s ta konkretizojnë në atë mënyrë që ta fillojnë procedurën për hulumtimin e mundësive ligjore për themelimin e KOMRA-s.

Pas takimit me kryetarin e Malit të Zi, anëtarët e ERAP e kanë mbajtur konferencën e parë për shtyp<sup>1</sup>, në të cilën i kanë njoftuar gazetarët me fazën e re të procesit të KOMRA-s si dhe me gatishmërinë e kryetarit të Malit të Zi që tek kryetarët e shteteve në rajon të angazhohet për themelimin e KOMRA-s.

Kryetari i Malit të Zi, Filip Vujanoviçi, në datën **15.01.2012**, i ka drejtuar një letër kryetarëve të shteteve në rajon, duke i ftuar ata që të formojnë një grup zyrtar të ekspertëve, i cili do të shqyrtonte Statutin e KOMRA-s, të cilin e propozon Koalicioni rajonal, dhe që ta harmonizojnë qëndrimin e tyre në pikëpamje të qëllimeve, detyrave dhe mandateve të propozuara të KOMRA-s.

### **Takimi i dytë i ERAP**

Takimi i dytë i ERAP është mbajtur në datën **24.02.2012** në Beograd. Tema kryesore e takimit ka qenë çështja e “bërthamës së fortë” të Propozim Statutit, të cilën do ta përfaqësojnë avokuesit publik me politikanët vendor. Duke e treguar nevojën për komisionin rajonal, Zharko Puhovski ka thënë: „Faktet mbi viktimat nuk mund të vërtetohen ndryshe pos në nivel rajonal, për arsye se i kanë vërshtuar kufijtë edhe ushtritë, edhe viktimat e edhe refugjatët përtej tyre. Dhe kësi kufijsh nuk ka pasur... Unë njëmend mendoj se kjo është themelore. Dhe nëse kroatët pohojnë se serbët i kanë sulmuar dhe se i kanë dërguar kroatët në kampe në Serbi, gjë që e tëra është e vërtetë, atëherë, vallë, a nuk mund ta kuptojnë se vet Kroacia nuk mund të kërkojë nëpër Nish e Stajiqevë se kush ku është torturuar dhe se ku gjendet dikush që është vranë atje.“ Në lidhje me qëllimet dhe detyrat e KOMRA-s, anëtarët e ERAP kanë përfunduar se ata i obligon fakti se Kuvendi i Koalicionit për KOMRA-n, i datës 26.03.2011, e ka miratuar Propozim Statutin e KOMRA-s, si dhe qëndrimin e të gjithë pjesëmarrësve të procesit konsultativ se për Koalicionin detyra më e rëndësishme (“bërthama e fortë”) është vërtetimi i fakteve mbi viktimat dhe krimet e luftës. Në përputhje me këtë, askush nuk ka të drejtë të heq dorë nga detyra më e rëndësishme e KOMRA-s. Gjithçka tjetër është e hapur për diskutim, duke pasur parasysh faktin që, nëse politikanët sjellin propozime konkrete, atëherë mbi këtë do të diskutohet konkretisht në Kuvendin e Koalicionit për KOMRA-n.

2

### **Strategjia fillestare e ERAP**

Në një komunikatë elektronike, ERAP në muajin mars të vitit 2012 e ka përpiluar planin fillestar të avokimit publik të Nismës së KOMRA-s, që nisët nga situata politike në secilin vend veç e veç dhe mjetet në dispozicion. Sipas këtij plani, avokuesit publik në Maqedoni dhe në Kosovë do t'i japin përparësi informimit të ambasadave të vendeve anëtare të BE-së, të vendeve skandinave dhe SHBA-së mbi progresin e procesit të KOMRA-s, kurse të drejtuarit kryetarëve të vendeve të tyre ta shtypnë, në mënyrë që të shqyrtohen efektet e angazhimit të kryetarit të Malit të Zi dhe të Kroacisë për institucionalizimin e Nismës së KOMRA-s. Avokuesit publik në Serbi do të fillojnë për evokimin e nismës pas zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në Serbi.

1 <http://www.zarekom.org/lajme/Konferenca-per-shtyp-dhe-pritja-tek-presidenti-Vujanovic-Koalicioni-per-KOMRA.sq.html>

## **Përkrahja e Përfaqësuesit të Lartë për Bosnjë e Hercegovinën**

Avokuesit publik në BeH, Zdravko Grebo, Dino Mustafiç dhe Xhenana Karup-Drushko, ia kanë paraqitur Nismën për KOMRA-n Përfaqësuesit të Lartë, Valentin Inzkos<sup>2</sup>, në datën **10.04.2012** në Sarajevë. Në takim ka marrë pjesë edhe Edina Gjukoviçi, drejtoreshë ekzekutive e organizatës joqeveritare kohët e fundit të formuar *Drejtësia Tranzicionale, Përgjegjësia dhe Kujtimi në BeH* (DTPK BeH).

Përfaqësuesi i Lartë posaçërisht ka theksuar potencialin e KOMRA-s se me emërimin dhe me pranimin e krimeve të kryera në rajon i kontribuojnë konsolidimit të paqes dhe qëndrueshmërisë së rajonit. Përfaqësuesi i Lartë ka propozuar që para verës të organizojë një takim të korit diplomatik, në të cilin avokuesit publik do t'i informonin ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së mbi procesin e KOMRA-s.

## **Përkrahja e ambasadorëve të Zvicrës, Gjermanisë dhe Norvegjisë në Maqedoni**

Avokuesi publik i Nismës për KOMRA-n në Maqedoni, profesoresha e Fakultetit Filozofik në Shkup, Biljana Vankovska, dhe avokuesi vendor Oliver Stanoeski, gjatë muajve **prill dhe maj** të vitit 2012, në një situatë jashtëzakonisht të pavolitshme politike, kanë pasur takime me ambasadorët e Zvicrës (ambasadorin Stefano Lazzarotto), të Gjermanisë (ambasadorin Gudrun Steinacker), dhe atë të Norvegjisë (ambasadorin Kjedit Paulsen). Duke pasur parasysh faktin se ky vend është përkrahës i fuqishëm i Nismës për KOMRA-n, biseda me ambasadorin norvegjez është treguar si një trokitje në dyer të hapura. Ambasadori Paulsen ka përsëritur se Norvegjia fuqishëm qëndron pas KOMRA-s dhe se ai do të informojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë mbi atë se edhe Maqedonia është e përfshirë në Nismën për KOMRA-n, dhe se nismën duhet përkrahur edhe në lidhje me këtë fakt. Ambasadori Lazzarotto ka premtuar se do të angazhohet para Ministrisë së Punëve të Jashtme të vendit të vet që të hulumtojë të gjitha mundësitë e përkrahjes për Nismën e KOMRA-s.

Ambasadorja Steinacker ka shprehur përkrahjen e saj personale dhe qëndrimin e qeverisë gjermane se përkrah procesin e dokumentimit të krimeve si një instrument i besueshëm që të arrihet deri te e vërteta që e rëndësishme për viktimat, por edhe për gjithë shoqërinë. Ambasadorja dhe zëvendësi i saj Ualter Leuchs e kanë vërtetuar gatishmërinë që në kontaktet e tyre me zyrtarët maqedonas të theksojnë se janë takuar me avokuesin publik dhe ia kanë dhënë përkrahjen e tyre për formimin e komisionit rajonal.

3

Ambasadorët kanë treguar edhe se marrëveshja mbi amnistinë e krimeve të luftës, mbi të cilën qëndron koalicioni qeveritar, është pengesë e madhe për hapjen e procesit të ballafaqimit me të kaluarën në Maqedoni.

## **Kryetari i Kroacisë, Ivo Josipoviç e ka përkrahur themelimin e Grupit Zyrtar të Ekspertëve**

Avokuesit publik të Nismës për KOMRA-n Zharko Puhovski, Natasha Kandiç, Zdravko Grebo dhe Dino Mustafiç – në datën **08.05.2012**, në Zagreb, kanë biseduar me kryetarin e Kroacisë Ivo Josipoviçin mbi nevojën e një përkrahjeje më të fuqishme në bartjen e procesit KOMRA në nivel ndërshtetëror<sup>3</sup>. Në takim kanë marrë pjesë edhe Mario Mazhiç nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Dejan Joviç, këshilltar kryesor politik për punë të jashtme i kryetarit Josipoviç, dhe Zrinka Vrabec Mojzesh, këshilltare për çështje shoqërore e kryetarit Josipoviç. Kryetari Josipoviç e ka përkrahur propozimin e avokuesve publik mbi formimin e Grupit zyrtar të ekspertëve rajonal, i cili do të shqyrtonte Statutin e KOMRA-s, të cilin e ka propozuar Koalicioni për KOMRA, që të japin mendimin e tyre mbi vërejtjet që KOMRA të marr kompetencat e organeve gjyqësore dhe të përpilojnë Propozim Statutin, të cilin do t'ua ofrojnë për shqyrtim qeverive të vendeve të rajonit. Kryetari Josipoviç do ta delegojë përfaqësuesin e tij si dhe do të ftojë kryetarët e tjerë të rajonit që të caktojnë ekspertët ligjor, të cilët do të marrin pjesë në punën e Grupit Rajonal të Ekspertëve. Kryetari Josipoviç personalisht do të angazhohet që ekspertët ligjor të hulumtojnë mundësitë juridike-kushtetuese të realizimit të Nismës për KOMRA-n në secilin vend të veçantë të rajonit. Në lidhje

2 <http://www.zarekom.org/lajme/Prfaqsuiesi-i-Lart-u-takua-me-avokatt-e-KOMRA-n-BiH.sq.html>

3 <http://www.zarekom.org/lajme/Presidenti-Josipoviç-njoftoi-angazhimin-pr-t-krijuar-KOMRA-n-sq.html>

me përfaqësuesin e tij personal në grupin rajonal të ekspertëve, ai do ta informoj ERAP. Kështu, kryetari i Kroacisë do të jetë kryetari i parë i cili do t'i përgjigjet ftesës së kryetarit të Malit të Zi, Filip Vujanoviqit, të drejtuar kryetarëve të vendeve të rajonit të datës 15.01.2012 që t'i qasen shqyrtimit të mundësive kush-tetuese –juridike për themelimin e KOMRA-s.

**Ambasadori amerikan në BeH, Patrick S. Moon**, në takim me avokuesit e Nismës për KOMRA-n, Zdravko Grebon, Dino Mustafiqin dhe Xhenana Karup-Drushkon, në datën **11. 05.2012** fuqishëm e ka mbështetur themelimin e KOMRA-s, duke iu referuar politikës së pajtimit të vendit të tij. Ai i ka lavdëruar qëllimet dhe të arriturat e deritashme në procesin KOMRA<sup>4</sup>.

Në takim in e avokuesve publik të Nismës KOMRA, Natasha Kandiçit dhe Dinko Gruhonjiçit, me **ambasadorët e vendeve anëtare të BE në Serbi**, në të cilin ka marrë pjesë edhe Maja Miçiq nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, në datën **21 qershor të vitit 2012** në Beograd, ambasadori Vincent Degert edhe njëherë e ka përsëritur përkrahjen e Komisionit Evropian për nismën rajonale për themelimin e KOMRA-s<sup>5</sup>. Ambasadorët kanë shprehur përkrahjen për nismën rajonale për tregimin e së vërtetës, duke e theksuar peshën e pranimit të të gjitha viktimave.

**Shefi i delegacionit të Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesi special i BE-së në BeH, Peter Sorensen**, në takim in me avokuesit publik, Zdravko Grebon, Xhenana Karup-Drushkon dhe me Dino Mustafiqin, në datën **9 qershor të vitit 2012 në Sarajevë**, ka thënë se ka “fjalë të lavdërimit për personat nga shoqëria civile, të cilët po vazhdojnë me përpjekjet e tyre për pajtimin. Bashkimi Evropian shpreson se kjo nismë njëmend do t'i kontribuoj zhvillimit të pajtimit dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në rajon.”<sup>6</sup>

**Adriatik Kelmendi është avokues publik i ri i Nismës për KOMRA-n në Kosovë.**

4

Në vend të Mentor Aganit, i cili për shkak të obligimeve familjare është tërhequr nga ERAP, avokues publik i Nismës KOMRA në Kosovë është bërë Adriatik Kelmendi, redaktor i televizionit *Kohavision*.

4 <http://www.zarekom.org/lajme/Ambasadori-amerikan-n-BeH-takohet-me-prfaqsuessit-e-Koalicionit-t-KOMRA-s.sq.html>

5 <http://www.zarekom.org/lajme/Avokuesit-publik-t-Nisms-KOMRA-n-takim-me-ambasadort-e-vendeve-t-BE-s.sq.html>

6 Komunikatë për shtyp, Delegacioni i BE-së në BeH, 9 korrik, 2012.



Komisioni Evropian.

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Fondit për të Drejtën Humanitare dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pozicionit të Bashkimit Evropian.